



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"

dhe

SHOQATES BJESHKATARE GJERAVICA



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

i lidhur ndërmjet palëve

1. **Universiteti "Haxhi Zeka"** në Pejë, të cilin e përfaqëson Prof. Dr. Armand Krasniqi, në cilësinë e Rektorit të këtij institucioni të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti)

dhe
2. **Shoqata Bjeshkëtare "Gjeravica"**, me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson Zejnullah Luta, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të kësaj shoqate (në tekstin e mëtejshëm: Shoqata ShB Gjeravica)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është krijimi i një kuadri për bashkëpunim ndërmjet palëve me synim përfshirjen aktive të studentëve të Universitetit në praktika profesionale, përvoja të drejtpërdrejta dhe angazhime në terren në fushën e turizmit malor, sporteve në natyrë dhe aktiviteteve edukative që organizohen nga ShB Gjeravica. Bashkëpunimi synon gjithashtu të fuqizojë rrjetëzimin dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet studentëve dhe profesionistëve të fushës.

Neni 2

Baza Ligjore

Ky memorandum bazohet në tërësi mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe akteve përkatëse për shoqatat joqeveritare dhe bashkëpunimin ndër-institucional.



Neni 3

Forma e Bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat vijuese:

- i. Përfshirja e studentëve në aktivitete praktike dhe angazhime në terren, të organizuara nga ShB Gjeravica në bashkëpunim me Universitetin, në kuadër të ngjarjeve publike, aktiviteteve sportive dhe atyre në natyrë.
- ii. Krijimi i mundësive të përbashkëta për përvojë të drejtpërdrejtë në organizimin, menaxhimin dhe logjistikën e eventeve të mëdha në natyrë dhe në turizëm.
- iii. Mundësimi i rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me profesionistë të sektorit të turizmit malor, guidave, sporteve në natyrë dhe organizatave të ngjashme;
- iv. Bashkëorganizimi i paneleve, trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve edukative me pjesëmarrje të studentëve dhe stafit akademik;
- v. Njohja dhe certifikimi i kontributit të studentëve përmes certifikatave apo referencave profesionale nga ShB Gjeravica, dhe mbështetje institucionale nga Universiteti për promovimin e këtyre përvojave.
- vi. Organizimi i praktikës së punës për studentë dhe/ose staf ndihmës, në koordinim të ndërsjellë dhe në përputhje me nevojat e të dyja palëve, me qëllim ngritjen e kapaciteteve.

Neni 4

Dispozitat Përfundimtare

- i. Ky memorandum do të shërbejë si kuadër për marrëveshje të mëtejme specifike për aktivitetet dhe projektet konkrete të përbashkëta;
- ii. Memorandumi mund të ndryshohet ose plotësohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve;
- iii. Memorandumi nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë, nga të cilët secila palë mban nga 2 (dy).



SHOQATA BJESHKATARE
GJERAVICA
1928 PEJË - KOSOVË

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mbetet në fuqi deri në nënshkrimin e një marrëveshjeje tjetër që e zëvendëson atë, ose në rast të shfuqizimit me marrëveshje të ndërsjellë.

Në emër të **Universitetit "Haxhi Zeka"** dhe **Shoqatës Bjeshtkatore "Gjeravica"**, palët nënshkruese deklarojnë vullnetin për bashkëpunim të ndërsjellë në përmbushjen e këtij Memorandumi.

Në Pejë, me ____ / ____ / 2025

Rektor i **Universitetit "Haxhi Zeka"**
Prof. Dr. Armand Krasniqi

Kryetar i **Shoqatës Bjeshtkatore "Gjeravica"**
Zejnullah Luta

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKË" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No.	874	Nr. / faq / Br. / Nr. / No. pg	4
Data / Datum / Date:	28.04.2025	Pejë / Peë	

